**Raport për rezultatet e konsultimeve publike**

1. **Titulli i draft aktit**

Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Agjendës Kombëtare të Refrormave 2024 – 2027”

2. **Kohëzgjatja e konsultimeve**

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Agjendës Kombëtare të Refrormave 2024 – 2027” u publikua në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më datë 14.06.2024. Konsultimi publik u mbyll më datë 12.07.2024.

Kohëzgjatja e konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ishte 30 ditë.

3. **Metoda e konsultimit**

Konsultimi publik u kryе përmes publikimit të projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Agjendës Kombëtare të Refrormave 2024 – 2027” në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike,
https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/744

4. **Palët e interesit të përfshira**

Qytetarët dhe grupet e interesit nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, ku projektvendimi i Këshillit të Ministrave, gjatë periudhës së publikimit u shikua nga 1099 persona. U paraqitën 72 komente nga Instituti për Bashkepunim dhe Zhvillim (CDI); Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Ëomen); Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE), Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV), Qendra Jonathan dhe Partners Albania.
Në datën 26 korrik u organizua një takim nga Sekretariati BE, me praninë e organizatave të mësipërme dhe përfaqësues nga ministritë e linjës, për të diskutuar mbi komentet e paraqitura.

5. **Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara**

| **Çështja e adresuar** | **Komenti** | **Palët e interesuara** | **Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I papranuar)** | **Justifikimi** |
|---|---|---|---|---|
| Mungesën e disa informacioneve të rëndësishme në dokumentin draft të AKR | -Një nivel detaji më i madh përsa i përket përmbatjes së një reforme. Titulli i reformës, mund të plotësohet me një paragraf që plotëson | Instituti për Bashkepunim dhe Zhvillim (CDI) | I pranuar | Adresuar në kuadër të detajimit të dokumentit të politikës së AKR 2024-2027, të miratuar si pjesë e këtij këtij vendimi. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | synimin me rezultatet e pritshme | | | |
| | -Kosto indikative e çdo reforme parashikuar deri në 2027; | Instituti për Bashkepunim dhe Zhvillim (CDI) | I pranuar | Kostot indikative të reformës janë reflektuar në masë të madhe në PBA 202-2026. Megjithatë, ky koment do të adresohet më tej edhe në në kuadër të PBA 2025-2027 dhe cikleve të tjerë të programimit buxhetit. |
| | -Mungojnë indikatorët përkatës. Të paktën një indikator për reformë do ta bënte të dukshëm rezultatin apo impaktin e pritshëm | Instituti për Bashkepunim dhe Zhvillim (CDI) | I pranuar | Është adresuar në kuadër të detajimit të dokumentit të politikës së AKR 2024-2027, miratuar si pjesë e këtij vendimi, ku përcaktohen qartësisht indikatorët dhe mënyra e përcaktimit të tyre për secilën fushë politike dhe reformë. |
| | -Përmendja e institucionit përgjegjës dhe/apo e atyre të përfshira për çdo reformë do të mundësonte gjithashtu një transparencë më të madhe, me rezultatin e pritshëm të një angazhimi më të madh dhe më cilësor të aktorëve sociale / shoqërisë civile aktivë; | Instituti për Bashkepunim dhe Zhvillim (CDI) | I pranuar | Është adresuar në kuadër të detajimit të dokumentit të politikës së AKR 2024-2027, miratuar si pjesë e këtij vendimi, ku përcaktohen qartësisht institucionet përgjegjëse për zbatim.<br>Konsiderohet adresimi edhe më tej, në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve te zbatimit të AKR 2024-2027, të parashikuar për miratim në vijim të këtij vendimi. |
| | -Shtimin e një reforme/mase afatmesme dhe afatgjatë me fokus vlerësimin e brendshëm të performancës dhe nivelit të përgatitjes institucionale për RGF në Shqipëri | Instituti për Bashkepunim dhe Zhvillim (CDI) | I pranuar pjeserisht | Konsiderohet si koment, në kuadër të ngritjes së mekanizmit dhe instrumentave të zbatimit, që do të ngrihen në kuadër të këtij vendimi. |
| | | | | |
| Politikat e tokës | Propozohen masa të konkrete për të mbrojtur të drejtat e grave për politikat e tokës.<br>*Assessment of the de facto situation of ëomen's (co-)oënership of immovable property*<br>*Assessment of the de facto situation of ëomen's (co-)oënership of agricultural* | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Ëomen) | I pranuar pjesërisht | Komenti i është përcjellë institucioneve përkatëse për t'u konsideruar gjatë procesit të hartimit të dokumentit të politikës së tokës, si masë e AKR 2024 – 2027 (reforma 1.1.2). |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *land*<br><br>*Gender impact assessment of land policy.*<br>*System in place for gender-sensitive monitoring of land oënership/registration.*<br><br>*Gender (impact) analysis*<br>*Gender-sensitive monitoring of services provided by State Cadastre Agency* | | | |
| Efektiviteti i gjyqësorit | -Sugjerohet të përfshihet në Plan një paketë konkrete masash të cilat sigurojnë akses në drejtësi për grupet e pafavorizuara të popullsisë, veçanërisht akses në drejtësi për ato çështje që ndikojnë veçanërisht dhe në mënyrë disproporcionale te gratë,<br><br>**Dedicated actions in support of enhancing women's/girls' access to justice:**<br>- Addressing all relevant aspects under Directive (EU) 2024/1385 of the European Parliament and of the Council of 14 May 2024 on combating violence against ëomen and domestic violence, PE/33/2024/REV/1, OJ L, 2024/1385<br>- Monitoring of court cases that bear particular relevance for ëomen's rights: violence against ëomen, gender-based violence, land (co-)oënership, alimony, custody, heritance, divorce<br><br>- Conduct in-depth analysis of and ensure adequate responses to (i) causes that still limit women's reporting of violence; and (ii) the low number of cases that make it into the judicial system for protection measures and prosecution of perpetrators<br>- Take measures to address the main causes that hinder | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Ëomen) | I papranuar | Në hartimin e draft Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, MD ka marrë në konsideratë dhe masat e parashikuara në AKR duke integruar perspektivat gjinore si dhe programet e shpenzimeve me synim adresimin e çështjes së përfaqësimit të grave në nivel më të lartë (për aq sa është e mundur) dhe bazuar në meritokraci. Një qëllim i politikës së MD është iniciativa "Drejtësi më e afërt për qytetarët" e parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë e synon krijimin e një sistemi dretësie më të aksesueshëm, transparent dhe të orientuar ndaj qytetarëve. Draft SND që po hartohet nga grupi i punës parashikon dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta mes institucioneve të drejtësisë dhe shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe qytetarëve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | law enforcement and the judiciary to take protection measures for victims of GBV, such as institutionalized misogyny, lack of knowledge about relevant legislation and the role of the police, lack of human resources, social pressure, and fear of retaliation from perpetrators especially in small communities<br>- Ensure that victims of GBV, including those from disadvantaged communities, enjoy priority access to legal aid and, in particular, court representation in both civil and criminal proceedings<br>- Take measures to uphold the principle of civil responsibility of all public officials who fail in their duty to take the necessary preventive or protective measures in accordance with international standards, including those who fail to enforce protection orders, by applying the relevant criminal sanctions<br>- Ensure psychological reports submitted before courts comply with the required criteria of professionalism and objectivity<br><br>- Assess whether relevant legislation on child marriage (e.g., the Family Code) creates loopholes for allowing child marriages, and address possible legal gaps<br>- Ensure that the judicial governing bodies exercise their mandate to supervise the court's practice in relation to child marriage<br>- Develop comprehensive legal frameworks and action plans with clear milestones and timelines for ending child marriage<br><br>- Provide dedicated, gender-sensitive training on legislation against trafficking | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | in human beings and the rights of victims for police, prosecutors and judges, including guidance on issues of consent and coercion in the context of labor and sex trafficking<br><br>- Revise the Code of Civil Proceedings with regards to provisions that relate to the burden of proof on civil proceedings related to discriminatory practice in accordance with the amended Law against Discrimination, the Labour Code, and the Code of Administrative Proceedings, which have reversed the burden of proof in favor of the plaintiff<br>- Increase capacities of the judiciary to effectively enforce anti-discrimination legislation, including the Law on Gender Equality<br>- Intensify legal measures - including those foreseen in the law on domestic violence and in civil and criminal procedure legislation - on the enforcement of court decisions, together with regular monitoring of these decisions, to ensure that cases of violation are duly identified and offenders duly prosecuted<br>- Increase bailiffs' professionality, capacity, and knowledge of the legislation on gender equality and violence against women<br>- Enforce the principle of civil responsibility of public officials who fail in their duty to enforce court decisions<br><br>- Ensure adequate financial and human resources to sustain existing free legal aid (FLA) services, and further development of the FLA system and its management institutions<br>- Strengthen the secondary legal aid system, including facilitating procedures for | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ensuring access, to ensure that women victims of GBV and women from disadvantaged communities benefit from representation in courts, as well as from exemption from court and expert fees, which represent a significant burden in family civil proceedings<br>- Provide adequate financial support to CSOs specialized in free legal aid, based on the criteria established by the law<br><br>- Ensure that any reform plan on the territorial distribution of courts is preceded by an ex ante gender impact assessment of women's access to justice, in line with EU methodology.<br><br>- Increase awareness and provide legal aid to women to ensure they fully benefit from improved provisions which enable the registration of joint property during marriage under the name of both spouses<br>- Increase knowledge and awareness among the general population about women's property and inheritance rights<br>- Increase capacities of public notaries, cadaster officials and judges, and enhance compliance monitoring, to ensure women benefit equally and are registered as co-owners of family joint property | | | |
| Ndihma shtetërore | -Përafrimi i ndihmës shtetërore me aktet ligjore të BE-së ndihmon për të siguruar që ndihma shtetërore të kontribuojë në reduktimin e pabarazive gjinore dhe nxitjes së rritjes ekonomike | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar pjesërisht | Ky koment i është adresuar institucionit përgjegjëse për ndihmen shtetërore, për tu konsideruar në proceset e tyre të planifikimit dhe zbatimit të masave për ndihmën shtetërore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | gjithëpërfshirëse.<br><br>State Aid is negotiated under Chapter 8, addressed in several EU acts. These measures aim to ensure equal benefits for both women and men, promoting substantive equality. Specifically, they focus on (i) the EU's gender- and socially responsive regulations for the administration of state aid (due to the direct impact of state aid on equal access to services, which includes but is not limited to social services); and (ii) gender equality requirements under the EU's public procurement rules.<br><br>The Commission Decision (2012/21/EU) on state aid for SGEI has significant gender relevance by promoting equal access to essential services, enforcing non-discriminatory and transparent state aid allocation, and emphasizing the importance of social services that disproportionately benefit women. By aligning with EU principles on gender equality, the Decision helps ensure that state aid contributes to the broader goal of reducing gender disparities and fostering inclusive economic growth.<br><br>2012/C 8/02: Communication from the Commission on the application of the European Union State aid rules to compensation granted for the provision of services of general economic interest<br><br>Commission Staff Working Document — Guide to the application of the European Union rules on state aid, public procurement and the internal market to services of general economic interest, and in particular to social services of general interest (SËD (2013) 53 final/2, | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 29.4.2013)<br><br>Commission Regulation (EU) No 651/2014 of 17 June 2014 declaring certain categories of aid compatible with the internal market in application of Articles 107 and 108 of the Treaty (Text with EEA relevance), OJ L 187, 26.6.2014, p. 1–78, notably as amended by Commission Regulation (EU) 2017/1084<br><br>2009/C 188/02: Communication from the Commission — Criteria for the analysis of the compatibility of State aid for the employment of disadvantaged and disabled workers subject to individual notification, OJ C 188, 11.8.2009<br><br>See the forthcoming GIZ SANECA II Gender Mapping of the Internal Market Chapters, esp. Chapter 8, for details. | | | |
| Mjedisi i biznesit/zhvillimi i sektorit privat | -Propozohen masa që (i) sigurojnë punë të denjë duke u mbështetur në harmonizimin me Direktivën e Raportimit të Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD) dhe Direktivën për Transparencën e Pagave; dhe (ii) rritjes së grave sipërmarrëse. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar pjesërisht | Komenti i është adresuar ministrisë respektive për t'u konsideruar në kuadër të masave të Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative, e cila është pjesë e masave të Dokumentit të Politikës AKR 2024 – 2027. |
| | Propozohen masa në kuadër të rregulloreve të BE për përgjegjësinë sociale dhe mundësitë e barabarta në vendin e punës, përfshirë inspektimin.<br>Under Chapter 20, several EU acts address corporate social responsibility and equal opportunities at the | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, të lidhur me aspektet e përgjegjësinë sociale dhe mundësitë e barabarta në vendin e punës, ku mund të adresohet kjo masë<br>Pesë fushat e politikave që përmban AKR janë përcaktuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | work place, which would need to be covered under **inspection of businesses** and reporting:<br>Directive (EU) 2022/2464 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2022 amending Regulation (EU) No 537/2014, Directive 2004/109/EC, Directive 2006/43/EC and Directive 2013/34/EU, as regards corporate sustainability reporting (Text with EEA relevance), PE/35/2022/REV/1, OJ L 322, 16.12.2022, p. 15–80 (Corporate Sustainability Reporting Directive – CSRD)<br>Directive 2006/54/EC of the European Parliament and of the Council of 5 July 2006 on the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation (recast) (OJ L 204, 26.7.2006<br>Council Directive 79/7/EEC of 19 December 1978 on the progressive implementation of the principle of equal treatment for men and women in matters of social security (OJ L 6, 10.1.1979)<br>Directive (EU) 2023/970 of the European Parliament and of the Council of 10 May 2023 on strengthening the principle of equal pay for equal work or work of equal value between men and women through pay transparency and enforcement mechanisms (Pay Transparency Directive) (Text with EEA Relevance), OJ L 132, 17.5.2023, p. 21–44<br><br>- Enhance co-ordination among data-producing institutions and INSTAT with the aim to compute EU-aligned gender indicators in the justice sector for Albania | | | nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.<br>Gjithsesi, ky koment i është adresuar institucionit përgjegjëse për politikat sociale, për konsiderim në proceset e tyre të planifikimit të politikave. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | - Engage in all steps required for establishing and monitoring EU-aligned gender indicators in the justice sector, in line with EU methodology | | | |
| | Propozohen masa te lidhura me aspektet gjinore të Shoqërive me Pronësi Shtetërore<br>Consider the application of **Directive (EU) 2022/2381.** This Directive focuses on improving the gender balance among directors of listed companies and related measures, is highly relevant to company law and corporate governance frameworks. The directive aims to address the **gender imbalance among directors by setting specific targets**: at least 40% representation of the under-represented sex among non-executive board members or 33% of all directors by 30 June 2026. While Albania currently lacks listed companies, the directive's principles align with Article 23 of the Charter of Fundamental Rights of the European Union, which mandates equality between women and men in all areas, including employment, work, and pay. Therefore, even in the absence of listed companies, measures towards alignment with gender equality objectives can be initiated, reflecting a commitment to fundamental rights and promoting inclusive corporate governance practices. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar pjesërisht | Ky koment i është adresuar institucionit përgjegjëse për politikat e ndërmarrjeve me pronësi shtetërore, për tu konsideruar në proceset e tyre të planifikimit dhe zbatimit të masave përkatëse. |
| Eksporti dhe tregtia | -Sugjerohen masa për monitorimin dhe analizimin sistematik të ndikimit të mundshëm gjinor të preferencave dhe marrëveshjeve tregtare<br>Monitoring and systematic | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027 të lidhur me aspektet e ndikimit të mundshëm gjinor të preferencave dhe marrëveshjeve tregtare.<br>Pesë fushat e politikave që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | analysis of the possible gendered impact of trade preferences and agreements (all ex-ante and ex-post evaluations of EU trade agreements contain a dedicated gender analysis) | | | përmban AKR janë përcaktuar nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithsesi, ky koment i është adresuar institucionit përgjegjëse për eksportet dhe tregëtinë, për konsiderim në proceset e tyre të planifikimit të politikave. |
| AFP | -Përfshirja e shtuar e vajzave/gruas në arsimin/trajnimin profesional dhe në STEM; rekomandohet referencë për harmonizim.<br><br>Add: Affirmative action/special measures for increasing the number of girls in VET<br>Gender target: increase in the number of girls attending VET<br><br>Several EU related acts are explicit on gender-responsive actions in support of inclusion, equal opportunities, increased involvement of girls/women in vocational training and in STEM:<br>Decision (EU) 2022/2481 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2022 establishing the Digital Decade Policy Programme 2030, PE/50/2022/REV/1, OJ L 323, 19.12.2022<br>COM/2020/624 final: Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions<br>Digital Education Action Plan 2021-2027 Resetting education and training for the digital age<br>Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar pjesërisht | Ky koment i është adresuar institucionit përgjegjës, qw tw konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve te zbatimit të AKR 2024-2027. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Social Committee and the Committee of the Regions, COM (2021) 118 final, 2030 Digital Compass: the European way for the Digital Decade<br>COM (2021) 350 Updating the 2020 New Industrial Strategy: Building a stronger Single Market for Europe's recovery | | | |
| Dixhitalizimi | -Disa akte të BE-së adresojnë nevojën për të zbatuar masa konkrete për mbylljen e divergjencave dixhitale: gjinia, mosha, urbane -rurale dhe sociale, dhe rekomandohet referencë për përafrim. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar | Ky koment i është adresuar institucionit përgjegjës, qw tw konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve te zbatimit të AKR 2024-2027. |
| Tregu i punës | Rekomandohet përafrimi me Direktivën (BE) 2019/1158 mbi balancën e "punë-jetë" për prindërit dhe kujdestarët. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027 të lidhur me aspektet e përafrimi me Direktivën (BE) 2019/1158 mbi balancën e "punë-jetë" për prindërit dhe kujdestarët..<br>Pesë fushat e politikave që përmban AKR janë përcaktuar nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.<br>Megjithatë, komenti i është adresuar ministrisë respektive për politikat e tregut të punës, për t'u konsideruar gjatë proceseve në vijim të planifikimit dhe integrimit ne BE. |
| Biznesi në axhendën e gjelbër dhe dixhitale | Rekomandohet që masat të përputhen me masat përgjegjese direkte gjinore të përcaktuara në aktet e BE-së. Kjo përfshin masa konkrete për promovimin e grave sipërmarrëse dhe për sigurimin dhe monitorimin e aksesit të barabartë në shërbimet e zhvillimit të | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar | Komenti i është adresuar ministrisë respektive për t'u konsideruar në kuadër të Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative, e cila është pjesë e masave të dokumentit AKR 2024 – 2027 (reforma 3.2.1.) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | biznesit dhe në produktet financiare,<br>Dedicated measures for promoting women's entrepreneurship<br>Monitoring system in place for gender-sensitive tracking of the delivery/provision of business development services<br>Monitoring system in place for gender-sensitive tracking of allocation/disbursement of financial business support measures | | | |
| Korrupsioni | Rekomandohen një sërë masash konkrete që synojnë adresimin dhe reduktimin e korrupsionit me ndikim gjinor, duke përfshirë monitorimin e treguesve ndërkombëtarë të korrupsionit me ndjeshmëri gjinore (SDG, UNODC). | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht, nuk ka fushë politike në AKR 2024-2027 të lidhur në mënyrë eksplicite me aspektet e treguesve ndërkombëtarë të korrupsionit me ndjeshmëri gjinore, lufta kundër korrupsionit targeton specifikisht lenten gjinore të masave antikorrupsion në draft-Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (ISAC) 2024-2030, e cila pritet të miratohet brenda vitit 2024. Strategjia (afati për konsultimin publik elektronik të së cilës u përmbyll më 31 gusht 2024) është dokumenti udhëheqës ombrellë që parashtron dhe detajon vizionin për prioritetet e luftës kundër korrupsionit. Dokumenti është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, duke njohur kontributin thelbësor të grave në ndërtimin e një shoqërie në zhvillim të qëndrueshëm. Pjesëmarrja e grave në identifikimin dhe avancimin e luftës kundër korrupsionit është trajtuar shprehimisht në një nga Objektivat Specifike të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Konkretisht, Objektivi specifik 3.4 parashikon: "*Forcimi i pjesëmarrjes së grave në identifikimin dhe luftimin e korrupsionit në nivele dhe sektorë të ndryshëm*". Ky objektiv përbëhet nga 2 nënobjektiva dhe 3 aktivitete të dedikuara. Arritja e këtij objektivi do të vlerësohet duke krahasuar numrin e projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor me numrin e tyre total gjatë tre viteve të fundit.<br><br>Si përfundim, kjo qasje krejtësisht e re strategjike do të rrisë në mënyrë gjithëpërfshirëse ndërgjegjësimin për ndikimin e korrupsionit tek gratë dhe vajzat. Konkretisht, përfshirja e një komponenti gjinor në projektet e mbështetjes së shoqërisë civile dhe në vlerësimin e shkallës së viktimizimit me bazë gjinore nga korrupsioni do të sigurojë që një pjesë e masave kundër korrupsionit të marra për shoqërinë të adresojnë në mënyrë specifike adresimin e nevojave dhe shqetësimeve. të grave dhe vajzave. |
| Sundimi i ligjit / Themelorët | Rekomandohet përfshirja e masave në mbështetje të përafrimit me aspektet përkatëse të Direktivës (BE) 2024/1385 kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.<br><br>**Add relevant measures on responding to and preventing VaW/GBV/DV** in line with the following EU acts:<br>- Directive (EU) 2024/1385 of the European Parliament and of the Council of 14 May 2024 on combating violence against women and domestic violence, PE/33/2024/REV/1, OJ L, 2024/1385<br>- Council of Europe | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, të lidhur me aspektet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.<br>Pesë fushat e politikave që përmban AKR janë përcaktuar nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.Megjithatë, komenti i është adresuar ministrisë respektive me kompetencë për politikat e barazisë gjinore, (përfshirë edhe zbatimin e Konventës së Stambollit) për t'u |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence (CETS No. 210) (Istanbul Convention) | | | konsideruar gjatë proceseve të lidhura me planifikimin strategjik dhe me integrimin ne BE.<br><br>Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë është në proces analizimi të Direktivës (EU) 2024/1385 në kuadër të Hartimit të Kodit të Ri Penal. |
| Sundimi i ligjit / Themelorët | Sugjerohen strategji për ndjeshmërinë gjinore për krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe të barabartë për gratë dhe burrat romë, në përputhje me parimet e politikës sociale dhe lëvizjes së lirë të punëtorëve brenda Bashkimit Evropian (COM/2010/0133 final<br>**Inclusion of Roma:**<br>Communication from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions The social and economic integration of the Roma in Europe, COM/2010/0133 final<br>By emphasizing the gender dimension in its approach to Roma integration, the communication seeks to promote equal opportunities and address disparities that hinder the full participation of Roma women in the labour market and society at large. It advocates for the inclusion of gender-sensitive strategies within overarching policy agendas, such as those related to education, employment, health, and territorial development. This holistic approach aims to create a more inclusive and equitable environment for Roma women and men, aligning with the principles of social policy and free movement of workers within the European Union. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, të targetuar per përfshirjen e romëve.<br>Pesë fushat e politikave që përmban AKR janë përcaktuar nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.<br>Megjithatë, komenti i është adresuar ministrisë respektive me kompetencë për politikat sociale, për t'u konsideruar gjatë proceseve të lidhura me planifikimin strategjik dhe me integrimin ne BE. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Menaxhimi i Financave Publike | Rekomandohet shtimi i referencave buxhetore për barazinë gjinore si një tregues i cilësisë dhe llogaridhënies.<br><br>**Under Budget/Public Finance Management:** Adding reference to **gender-responsive budgeting** as a quality and accountability marker is recommended. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar pjesërisht | Konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve te zbatimit të AKR 2024-2027.<br>Gjithashtu, ky koment i është adresuar Ministrisë së Financave e cila është përgjegjëse për buxhetimin gjinor, për tu konsideruar gjatë ciklit të buxhetimit. |
| Prokurimi Publik | Rekomandohet që të përmendet në mënyrë të qartë prokurimi publik për barazinë gjinore (GRPP), në mbështetje të përafrimit me Direktivën (BE) 2023/970 (Direktiva për Transparencën e Pagave). Duke theksuar parimet e pagave të barabarta në praktikat e prokurimit,<br>**Under Public Procurement:** It is recommended to explicitly mention **gender-responsive public procurement** (GRPP), in support of alignment with Directive (EU) 2023/970 (Pay Transparency Directive). By emphasizing equal pay principles in procurement practices, the directive advocates for gender-responsive public procurement policies. It encourages competition policy frameworks to integrate gender equality considerations, fostering a fair and inclusive marketplace. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, të lidhur me aspektet e prokurimit publik apo hendekut të pagave.<br>Pesë fushat e politikave që përmban AKR janë përcaktuar nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.<br>Gjithsesi, ky koment i është adresuar institucioneve përgjegjëse për politikat “gender” dhe për politikat e prokurimit publik, për t’u shqyrtuar gjatë përgatitjes së politikave të tyre specifike, sektoriale. |
| | -Masa konkrete rekomandohen të ndërmerren dhe zbatohen për të mbyllur divergjencat e vazhdueshme gjinore (Direktiva 2010/41/BE): | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Aktualisht nuk ka fushë politike në dokumentin e politikës AKR 2024-2027, të lidhur me aspektet e hendekut gjinor.<br>Pesë fushat e politikave që përmban AKR janë përcaktuar nga ana e Komisionit Evropian në mënyrë të ngjashme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Megjithatë, komenti i është adresuar ministrisë respektive me kompetencë për politikat e barazisë gjinore, për t'u konsideruar gjatë proceseve të lidhura me planifikimin strategjik dhe me integrimin në BE. |
| | -Në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet e BE-së, të gjitha statistikat që lidhen me individët duhet të ndahen vazhdimisht sipas gjinisë dhe - sipas nevojës - sipas moshës, si dhe karakteristikave të mëtejshme.<br><br>Data needs to be sex disaggregated data | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I pranuar pjeserisht | Konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve të zbatimit të AKR 2024-2027. |
| Auditimi | Auditimi me bazë gjinore është një mekanizëm standard i BE-së dhe rekomandohet të përmendet në mënyrë të qartë në kontekstin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për të zgjeruar në mënyrë të njëpasnjëshme auditimet e tij me bazë gjinore në sektorët kyç të zhvillimit dhe reformës.<br>**Under Audit**<br>The Supreme State Audit Institution (SSAI) recently conducted a performance audit on the "Economic Empowerment of Women in our Country". Gender audit is a standard EU tool and is recommended to be explicitly mentioned in the context of SSAI successively expanding its portfolio of **gender audits in key development and reform sectors**. | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave<br>(UN Women) | I papranuar | Konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve të zbatimit të AKR 2024-2027.<br>Ky koment i është adresuar institucionit të Ministrisë së Financave, për masa të lidhura me auditimin dhe kontrollin financiar. |
| | -pyetje: cili institucion apo organ qeveritar është parashikuar të jetë në krye të | Organizata e Kombeve të Bashkuara për | I papranuar | Dokumenti politik i AKR 2024-2027 nuk paraqet përgjigje për këtë pyetje. Proceset e lidhura me |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | monitorimit të përputhshmërisë së kërkesave dhe standarteve të barazisë gjinore? | Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) | | dokumentin e politikës AKR 2024-2027 orientohen nga ana metodologjike nga Komisioni Evropian, në bazë të Rregullores 2024/1449. Edhe aspektet e monitorimit do të orientohen nga udhëzimet e KE. |
| Energjia | Përgatitja e nje plani masash per te adresuar varferine energjitike, perfshire aspektet gjinore dhe mbrojtjen e konsumatoreve te prekur nga varferia.<br><br>**Drafting a gender-responsive** plan of measures to address energy poverty and protection of vulnerable consumers | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) | I pranuar | Dokumenti i politikës së AKR 2024-2027 përmban si masë hartimin e metodologjisë për përcaktimin e grupeve të prekura nga varfëria energjitike. Ky koment i është adresuar institucionit përgjegjës per energjinë, me qëllim për ta konsideruar gjatë zbatimit të kësaj mase. |
| | | | | |
| Sundimi i ligjit | Të shqyrtohet mundësia për sigurimin e harmonizimit të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024 – 2027 me dokumentet e tjera përkatëse të politikave dhe strategjive që kanë lidhje me Agjendën e BE-së | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Dokumenti i politikës së AKR 2024-2027 është hartuar në harmoni të plotë me kuadrin strategjik të vendit, përfshirë SKZHIE 2030, strategjitë sektoriale, si edhe ERP 2024-2026.<br><br>Per më tepër, ky koment do të konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve të zbatimit të AKR 2024-2027, të parashikuar për miratim në vijim të këtij vendimi. |
| | Të shihet mundësia që afatet të lejojnë kohën e mjaftueshme të nevojshme për proceset të cilat janë objekt i reformave. | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Dokumenti i politikës së AKR 2024-2027 është hartuar duke mbajtur si parim realizueshmërinë e masave për reformat, me qëllim arritjen e synimeve.<br><br>Per më tepër, ky koment do të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve te |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | zbatimit të AKR 2024-2027, të parashikuar për miratim në vijim të këtij vendimi. |
| | Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027 të rishikohet në këndvështrimin e konsistencës. | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Dokumenti i politikës së AKR 2024-2027 është hartuar duke mbajtur si parim të përfshirit të treguesve sasiorë dhe cilësore të matshëm.<br>Ky koment konsiderohet më tej për tu adresuar në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve të zbatimit të AKR 2024-2027, të parashikuar për miratim në vijim të këtij vendimi. |
| | Të përpunohen më tej "hapat cilësorë ose sasiorë" që duhet të ndërmerren për të realizuar Reformat Indikative, duke i bërë ato më të matshme; | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Është adresuar në kuadër të detajimit të dokumentit të politikës së AKR 2024-2027, miratuar si pjesë e këtij vendimi, ku përcaktohen qartësisht hapat cilësore dhe sasiore për zbatim.<br>Konsiderohet të adresohet edhe më tej, në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve të zbatimit të AKR 2024-2027. |
| | Të harmonizohet metodologjia e "hapave cilësorë ose sasiorë", duke i bërë ato ose me natyrë të përgjithshme ose të veçantë në të gjithë dokumentin. | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Metodologjia është përpunuar nga Komisioni Europian dhe bazohet ne Rregulloren e BE 2024/1449 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian, miratuar me 14 Maj 2024.<br>Konsiderohet të adresohet më tej në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve të zbatimit të AKR 2024-2027 |
| Gjyqësori | Të shihet mundësia për më shumë sqarime se si Kuvendi do të garantojë standardet dhe integritetin e emërimit të anëtarëve jo-magjistratë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të shqyrtohet nevoja për ndryshime ligjore në kuadrin ligjor aktual. | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Ky aspekt është konsideruar gjatë diskutimeve të brendshme, si edhe gjatë negociimeve me BE dhe është riformuluar masa 5.1.2. në lidhje me integritetin e emërimit të anëtarëve të KLGJ e KLP. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Demokracia, të drejtat themelore dhe shoqëria civile | Reforma Indikative 5.5.2 të përpunohet më tej ose t'i ndërrohet emri. | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I papranuar | Pas diskutimeve, edhe me Komisionin Evropian, komenti nuk është marrë në konsideratë. |
| | Të mbahen parasysh standardet, parimet dhe udhëzimet ndërkombëtare të promovuara dhe ofruara nga Këshilli i Evropës në çuarjen përpara të reformës për shpifjen | Organizata per Bashkepunim dhe Siguri ne Evrope (OSBE) | I pranuar | Reforma për shpifjen është përfshirë plotësisht nën masën 5.6.1. Ndryshimet ligjore për sa i përket aspekteve penale dhe civile të shpifjes dhe përafrimi i tyre me standardet evropiane janë parashikuar si masë në AKR dhe janë në përputhje me parashikimet e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM 736 Datë 13.12.2023. |
| | | | | |
| Kapitali Njerëzor / Komponenti 1.2 Arsimi 2.1.4 Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike. | -Futja e lëndës së higjenës kibernetike në të gjitha klasat e arsimit bazë dhe trajnimi i mësuesëve mbi konceptet kyçë dhe të thelluara të sigurisë kibernetike. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Vendosja e partneriteteve me organizatat e shoqerisë civile, lokale dhe kombëtare, në sigurimin e vazhdueshëm të transferimit të dijeve dhe inovacioneve në sigurinë kibernetike tek mësuesit e të gjitha klasave të arsimit bazë. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Futja e lëndës së Edukimit për Median dhe Informacionin në të gjithë nivelet e arsimit si lëndë bazë me detyrim e shoqëruar me kualifikimet e vazhdueshme të stafit pedagogjik dhe bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin e gazetarëve për të konsoliduar Edukimin për Median and Informacionin. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| Shtimi i një reforme | -Përgatitja e një dokumenti | Qendra Shkencë | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| indikative të re: 2.1.5 Rishikimi dhe përmirësimi i këshillimit të karrierës në arsimin parauniversitar | vlerësimi të efektivitetit dhe eficencës të këshillimit të karrierrës në arsimin 9 vjeçar. (qershor 2025) | dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | | institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Fuqizimi i këshillimit të karrierës si orë mësimore në gjimnaz, në klasat 10-11. (shtator 2025) | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Krijimi i partneriteteve me IAL-të për fuqizuar orientimin e karrierës në klasën e 9të, dhe klasat 10-12. (dhjetor 2025) | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Vendosja në programet e këshillimit të karrierës së orëve të hapura, për të mësuar e ndarë mbi orientimin e tregut të punës, kërkësat e tregut për profesione, dhe profesionet e te ardhmes. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| Shtimi i një reforme indikative të re: 2.1.6 Edukimi STEM dhe rritja e përfaqesimit të grave në STEM | -Krijimi i programeve kombëtare për provmomin e edukimit në STEM në të gjithë vendin (qershor 2025) | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar | Aktualisht, dokumenti i politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” përmban masën: “*Përditësimi i kurrikulës bazë në arsimin parauniversitar, me qëllim për të lidhur arsimin me nevojat e tregut të punës, përkatësisht në lëndët “Shkencat e natyrës, Artet, Teknologjia dhe TIK, dhe Gjuhët dhe Komunikimi*” |
| | -Studim kombëtar prë të identifikuar barrierat strukturore e sociale që pengojnë rritjen në karrier të grave në STEM | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Përfshirja e Ditës Ndërkombëtare të Grave dhe Vajzave në STEM në | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni pergjegjes për të parë mundësinë e përfshirjes në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | agjendën e aktivteteve të përvitshme të MAS, bashkive dhe institucioneve parauniversitare të edukimit | (SCiDEV) | | kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| | -Krijimi i një organizmi ndërsektoral shumëpalësh nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit, për të adresuar çështje që lidhen me rritjen e përfaqësimit të grave në STEM | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale për zbatim. |
| Kërkim & Zhvillim, Reforma Indikative 2.3.1 Forcimi i mjedisit kombëtar të Kërkimit dhe Inovacionit, | -Institucioneve kërkimore dhe universiteteve miratojnë praktikat e shkencës së hapur dhe e përfshirë shkencën e hapur edhe si kusht për financimin publik për kërkimin si psh nga fondet e kërkimit të AKKSHI apo fondet për start up. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Aktualisht, dokumenti i politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” përmban masën:<br>*Krijimi nga Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor i një platforme për promovimin e Shkencës së Hapur, duke u dhënë studiuesve shqiptarë akses në botimet kërkimore të mundësuara nga institucionet e tyre (Qershor 2027).*<br>Komenti po shqyrtohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të zbatimit të masës së mësipërme në programet sektoriale. |
| | -Financimi dhe Mbështetja për Infrastrukturën e Shkencës së Hapur: Sigurimi i fondeve për zhvillimin e infrastrukturës digjitale që lehtëson qasjen e hapur në të dhënat shkencore, jo vetëm publikimet finale dhe Krijimi i platformave kombëtare për shpërndarjen dhe ruajtjen e të dhënave të hapura shkencore dhe jo vetëm publikimet finale. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Aktualisht, dokumenti i politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” përmban masën:<br>*Krijimi nga Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor i një platforme për promovimin e Shkencës së Hapur, duke u dhënë studiuesve shqiptarë akses në botimet kërkimore të mundësuara nga institucionet e tyre (Qershor 2027).*<br>Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e përfshirjes në kuadër të zbatimit të masës së mësipërme në programet |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | sektoriale. |
| | -duhet me patjetër të ketë angazhim për rritjen e investimit publik në kërkim dhe zhvillim dhe inovacion: Rritja e përqindjes së investimeve në kërkime dhe inovacion deri në 1% të PBB-së deri në vitin 2027 dhe deri në 2% në 2030 për të kultivuar një gjeneratë kërkuesish, ekspertësh, inovatorësh dhe mendimtarësh që mund të ripërcaktojnë të ardhmen e rajonit, të sigurojnë mundësi për qarkullimin e trurit dhe të tërheqin talente duke bashkëpunuar me kolegët në rajon, BE dhe diasporë | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës në kuadër të angazhimeve të strategjisë së kërkimit shkencor. |
| | -Qeveria Shqiptare duhet të alokohej burime financiare të mjaftueshme dhe të nxisë integrimin e infrastrukturave kërkimore kombëtare dhe rajonale në infrastrukturat kërkimore panevropiane dhe rrjete (ERICs). Kjo nënkupton sigurimin që shpenzimet bazë, si tarifat e anëtarësimit dhe aktivitetet kryesore, të mbulohen nga buxhetet kombëtare për kërkimin dhe inovacionin | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës në kuadër të angazhimeve të strategjisë së kërkimit shkencor. |
| Digjitale, Komponenti 3.1 Digjitale, Reforma Indikative 3.1.1 Përputhshmëria me rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i e-Portofolit Digjital për shërbimet publike: të shtohen masat/hapat: | -Realizimi i një studimi mbi implikimet e identitetit digjital ne Shqipëri, shoqëruar më një matrix të rreziqeve dhe risqeve. (Janar 2026 | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Reforma mbi Përputhshmërinë me Rregulloren e Identitit Digjital dhe zbatimin e Portofolit Digjital për shërbimet publike vjen si rezultat i Planit të Rritjes (Growth Plan) të hartuar nga Komisioni Europian për të afruar vendet e Ballkanit Perendimor dhe BE-në, me synimin përshpejtimin e reformave, rritjen e ekonomive të tyre si dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka filluar punën për përafrimin e rregullores më të fundit të Identitetit Digjital (përkatësisht Rregulloren nr. 2024/1183 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 prill 2024, duke ndryshuar Rregulloren (BE) nr 910/2014 mbi ngritjen e Kornizës Evropiane të Identitetit Dixhital) me kuadrin ligjor për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, duke qënë se në Rregulloren eIDAS 2 parashikohet për herët të parë politika e Portofolit të Identitetit Digjital, si dhe mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij në BE. Në zbatim të kuadrit ligjor të lartpërmendur, AKSHI si institucioni përgjegjës për qeverisjen elektronike do të vijojë zbatimin e këtij projekti në faza të përcaktuara me ndihmën e partnerëve europianë. Gjithashtu, kjo reformë specifike përfshin Shqipërinë në rang kombëtar dhe aktualisht nuk mund të kryhet një studim mbi implikimet e identitetit digjital ne Shqipëri, shoqëruar më një matricë të risqeve, duke qenë se aktualisht fokusi është në zbatimin e masave konkrete të reformës digjitale dhe përafrimin e Acquis të BE. Megjithatë, në vazhdën edhe të zhvillimeve pozitive të lartpërmendura, ky studim do të konsiderohet në vijim, në kuadër edhe të iniciativave dhe politikave që do të ndërmerren nga ana e institucionit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | -Krijimi i programeve themelore të rritjes së kapaciteteve teknike, ligjore dhe të kuptueshmërisë për administratën që do të punoj/trajtoj element që lidhen me identitetin digjital. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës, në kuadër të përafrimit me rregulloren e re të Bashkimit Evropian për Identitetin Digjital, si edhe në kontekstin e zbatimit të masave përkatëse. |
| të shtohet reforma indikative 3.1.4 Krijimi dhe avancimi i kulturës së higjenës kibernetike | Krijim i programeve kombëtare dhe lokale për rritjen e kulturës së higjenës kibernetike në të gjitha institucionet publike pjësë të infrastrukturës kritike | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës, në kuadër të angazhimeve aktuale për politikat e sigurisë kibernetike, përmes trajnimeve për ritjen e kapaciteteve institucionale |
| | AKSK në bashkëpunim me ASPA përgatit dhe zbaton programe vjetore të rritjes së kapaciteteve të higjenës kibernetike për të gjithë pëjsëtarët e shërbimit civil | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Aktualisht, ekzistojnë trajnime të ASPAs, në bashkëpunim me AKSK për sigurinë kibernetike.<br>Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës, në kuadër të angazhimeve të mëtjeshme për politikat e sigurisë kibernetike dhe rritjes së kapaciteteve për sigurinë kibernetike. |
| Sundimi i Ligjit/Themelorët, Komponenti 5.5 Demokracia dhe të Drejtat Themelore dhe Shoqëria Civile, reforma indikative 5.5.2 Rritja e Lirisë së Shprehjes në përputhje me standardet europiane: | Duhet të sigurohet që hapat të jenë në përputhje të plotë me Udhërrëfyesin e Shtetit të Së Drejtës miratuar në Dhjetor 2023 dhe standardet e Këshillit të Europës, BE-së dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar | Të gjitha masat e dokumenti politik të Agjendës së Reformave 2024-2027, janë në përputhje me Udhërrëfyesin e Shtetit të Së Drejtës miratuar në Dhjetor 2023, standardet e Këshillit të Europës, BE-së dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias. Ministria e Drejtësisë është duke marrë në konsideratë të gjitha parashikimet e AKR, gjatë hartimit të Kodit të ri Penal. |
| | Duhët të synohet përafrimi i legjislacionit me Media Freedom Act për të adresuar element kryesorë të lirisë së medias në Shqipëri | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do ëtë konsiderohet nga institucionet përgjegjëse, në kuadër të politikave dhe programeve në vijim. |
| | Duhet të synohet përafrimi i legjislacionit me Digital Service Act | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar | Aktualisht, dokumenti i politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027" përmban masën "*Kryerja e vlerësimit të ndikimit të politikës dhe analizë së hendekut ligjor në lidhje me Rregulloren e Aktit të Shërbimit* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Digjital të Bashkimit Evropian, me synimin për ta përafruar në legjislacionin kombëtar, për të rritur mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve dhe përmbajtjen e sigurt (Qershor 2025) dhe miratimin e ndryshimeve ligjore për të përafruar gjerësisht Rregulloren e Aktit të Shërbimit Digjital (Qershor 2026)*". |
| | Krijimi i një grupi ndersektoral, me perfaqesues te sektorit privat, organizatave te shoqerise civile, dhe organizmave ndërkombëtarë për të konsultuar përfaqrimin e legjislatcionit me Digital Service Act dhe Media Freedom Act | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës në kuadër të zbatimit të masës perkatëse lidhur me Digital Service Act. |
| | Duhet të sigurohen masa për përdorim të përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale në përputhje me të drejtat e njeriut dhe me në qendër njeriun. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucionet përgjegjëse në kuadër të zbatimit të politikave dhe programeve në vijim lidhur me Inteligjencën Artificiale |
| | Masat për dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës janë të përsëritura por kërkojnë veprim konkret dhe vullnet politik e institucional që të realizohen. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Konsiderohet të adresohet në kuadër të mekanizmit dhe mjeteve te zbatimit të AKR 2024-2027. |
| **Duhet të shtohen masat:** | Zhvillimi i një plani të detajuar për mbrojtjen e gazetarëve: Kjo përfshin krijimin e një mekanizmi të shpejtë reagimi për incidentet që përfshijnë gazetarë dhe zhvillimin e programeve të trajnimit për organet e ligjzbatuese mbi të drejtat e njeriut dhe lirinë e medias. | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Aktualisht ka një masë nën 5.6.1. për *"Rritja e kapaciteteve të organeve ligjzbatuese për të trajtuar rastet e dhunës, duke incidentet periferike të protestave, dhe çështje të tjera penale që përfshijnë gazetarët, veçanërisht duke siguruar nivel të lartë për respektimin e të drejtave të njeriut në trajtimin e incidenteve që përfshijnë gazetarë, përmes udhëzimeve detyruese, mbledhjes së të* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *dhënave dhe masave për ngritjen e kapaciteteve”.*<br>Institucionet shqiptare, prej vitit 2023, kanë filluar t`i kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtes së gazetarëve. Konkretisht, KLGJ dhe PP kanë caktuar në çdo prokurori dhe gjykatë nga një gjyqtar dhe prokuror që ndjek çështjet me palë gazetarët ndërsa Shkolla e Magjistraturës dhe Akademia e Policisë në zbatim dhe të masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, kanë parashikuar të rrisin numrin e trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë, punonjës policie, me qëllim sjelljen adekuate dhe garantimin e të drejtave të gazetarëve në përgjithësi dhe në kuadër të protestave në veçanti. |
| | Ndërtimi i kapaciteteve për gjyqtarët dhe prokurorët: Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të trajtuar me kompetencë rastet që përfshijnë gazetarë dhe të drejtat e njeriut (duke përfshirë SPAK, BKH si edhe KLGJ, KLP, ILD). | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCIDEV) | I pranuar pjesërisht | Aktualisht ka një masë 5.6.1., ku gjatë zbatimit, do të përfshihet edhe trajnimi i gjyqtareve dhe prokuroreve për çështjet e gazetarëve:<br>*“Rritja e kapaciteteve të organeve ligjzbatuese për të trajtuar rastet e dhunës, duke incidentet periferike të protestave, dhe çështje të tjera penale që përfshijnë gazetarët, veçanërisht duke siguruar nivel të lartë për respektimin e të drejtave të njeriut në trajtimin e incidenteve që përfshijnë gazetarë, përmes udhëzimeve detyruese, mbledhjes së të dhënave dhe masave për ngritjen e kapaciteteve.”* |
| | Platforma e Hapur e të Dhënave: Zhvillimi mëtejshëm dhe konsolidimi i një platforme të hapur të të dhënave ku të gjitha të dhënat publike dhe dokumentet e | Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) | I pranuar pjesërisht | Dokumenti i politikës AKR 2024-2027 përmban masën 5.6.1. që lidhet me rritjen e transparencës për shpenzimet buxhetore dhe për deklarimin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | qeverisë të jenë të aksesueshme online për qytetarët dhe gazetarët duke përforcuar aksin në informacion. | | | pasurive, përmes përmirësimit të platformave përkatëse të të dhënave.<br>Komenti do të konsiderohet në vijimësi nga institucionet përgjegjëse në kuadër të politikave aktuale. |
| | | | | |
| 1.1. Mjedisi i biznesit/.1.1. Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe e sistemit tatimor, veçanërisht nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA). | Përfshirja në SAA i minimizimit të transaksioneve cash në vend | Qendra Jonathan | I pranuar | Në draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) (pjesë e masave nën dokumentin politik të AKR 2024-2027), që është në proces hartimi nga Ministria e Financave është parashikuar si komponent i Strategjisë:<br>Komponenti 2.2 "Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi", nën Shtyllën 2 të Mirëadministrimit Tatimor. |
| 2.1Arsimi/<br>2.1.1Rishikim i sistemit të AFP-së për të përshtatur më mirë kërkesën për aftësi të tregut të punës | Një problematikë aktuale me kurrikulat e arsimit dhe formimit profesional është papërshtatshmëria e tyre për të gjithë personat. E konsiderojmë të një rëndësie të veçantë specifikimi që këto kurrikula të jenë gjithëpërfshirëse ku instrumenta specifik janë lehtësisht të lexueshëm dhe kuptueshëm. | Qendra Jonathan | I pranuar pjesërisht | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës në kuadër të zbatimit të masave të Agjendës Kombëtare të Reformave. |
| 2.1.2Përditësimi i kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm | Sugjerojmë që të specifikohet se përditësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës | Qendra Jonathan | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e zbatimit në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale. |
| 2.1.4 Përparimi në aftësitë dhe arsimin digjital për të rinjtë dhe sigurimi i pajisjeve të mjaftueshme TIK për shkollat dhe universitetet publike. | Rekomandojmë futjen e Smart Boards për shkollat speciale dhe konsiderimi në dixhitalizim të nxënësve me nevoja të posaçme. | Qendra Jonathan | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e zbatimit në kuadër të programeve e strategjive aktuale sektoriale. |
| 2.2.1Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Papunësisë | Rekomandojmë kategorizimin e kujdestarëve të familjarëve me nevoja të posaçme si të punësuar ku vitet e kujdesit konsiderohen | Qendra Jonathan | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës për të parë mundësinë e zbatimit në kuadër të programeve e strategjive aktuale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | vjetërsi pune. | | | sektoriale. |
| 3.2.1Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe shfrytëzimi nga ana e tyre i potencialit të agjendës së gjelbër dhe digjitale, përfshirë mundësitë e rëndesishme të mbështetjes financiare. | Sugjerojmë të shtohet dhe Sipërmarrjes Sociale. | Qendra Jonathan | I papranuar | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës në kuadër të zbatimit të politikave aktuale sektoriale. |
| 2.1.3. Perditesimi i Kornizes Kombetare te Kualifikimeve, duke vendosur nje marredhenie te qarte dhe transparente ndermjet niveleve kombetare te kualifikimeve dhe niveleve perkatese te Kornizes Evropiane te Kualifikimeve; Hapat cilesore ose sasiore: Rregullimi dhe miratimi i kuadrit per njohjen/vlefshmerine e pervojes se meparshrne te te mesuarit joformal dhe informal dhe perfshirja e kualifikimeve pergjate gjithe jetes, perfshire mikrokredencialet, ne Komizen Shqiptare te Kualifikimeve. (Qershor 2026) | Ky proces duhet te kryhet ne konsultim dhe partneritet me organizatat e shoqerise civile (OSHC). Duke qene se OSHC-te luajne nje rol te rendesishem dhe jane nje nder aktoret kryesore ne ofrimin e te mesuarit joformal dhe informal. | Partners Albania | I pranuar pjesërisht | Komenti do të konsiderohet nga institucioni përgjegjës në kuadër të zbatimit të masës përkatëse të Agjendës Kombëtaretë Reformave dhe mekanizmat zbatues. |
| 3.2 Pervetesimi nga biznesi i potencialit te agjcndes se gjelber dhe dixhitalc; | Rekomandojme te shtohet " .... nga biznesi dhe organizatat e shoqërisë civile i potencialit te agjendes se gjelber dhe dixhitale; | Partners Albania | I papranuar | Komenti i është përcjellë institucionit përgjegjës, për tu konsideruar në kuadër të zbatimit të politikave dhe programeve përkatëse. |
| 3.2 Pervctesimi nga biznesi i potencialit te agjendes se gjelber dhe | Rekomandojme te shtohet " ..... SME-te dhe/ose startup-et, dhe organizatat e shoqerise | Partners Albania | I papranuar | Komenti i është përcjellë institucionit përgjegjës, për tu konsideruar në kuadër të zbatimit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dixhitale; Reform a indikative 3 .2.1.Permiresimi i mjedisit mundesues per bizneset inovative dhe shfrytezimi nga ana e tyre i potencialit te agjendes se gjelber dhe digjitale, perfshire mundesite e rendesishme te mbeshtetjes financiare; Hapat cilesore ose sasiore; Pergatitja dhe ekzekutimi i nje skeme grantesh me fokus tek SME-te dhe/ose startup-et, ku 30% e totalit te SME-ve dhe/ose fondeve te startup-eve synojne zgjidhje te gjelbra dhe/ose dixhitale. (Dhjetor 2025) | civile, ku 30% e totalit te SME-ve dhe/ose fondeve te startup-eve synojne zgjidhje te gjelbra dhe/ose dixhitale. (Dhjetor 2025) | | | të politikave dhe programeve përkatëse. |
| 5.1.1 Krijimi i nje Zyre per Rikuperimin e Pasurive, si Njesi Kombetare Koordinuese dhe pike kontakti rajonale/nderkombetare, duke kontribuar ne permiresimin e konfiskimeve; Hapat cilesore ose sasiore; 50% e numrit dhe vleres se pasurive te konfiskuara riperdoren (perfshi riperdorimin social) brenda 6 muajve nga konfiskimi. (Dhjctor 2026) | Ne kollonen "Hapat cilesore dhe sasiore", rekomandojme te shtohet nje tjeter mase per kete komponent dhe reform indicative, respektivisht: Permiresimi i kuadrit ligjor mbi riperdorimin social te pronave te konfiskuara, me nje rol te shtuar te institucioneve te veteqeverisjes vendore. Reference: Studimi nga Partneret Shqiperi per Ndryshim dhe Zhvillim. | Partners Albania | I papranuar | Komenti i është përcjellë institucionit përgjegjës, për tu konsideruar në kuadër të zbatimit të politikave dhe programeve përkatëse. |
| 5.2.2. Sigurimi i nje kornize te besueshme dhe te qendrueshme per | Nese strategjia pritet te miratohet ne dhjetor 2024 (sikurse paraqitet ne draft | Partners Albania | I pranuar pjesërisht | Pritet që edhe strategjia edhe plani i veprimit 2024-2030 të miratohen përpara dhjetorit 2024. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| te parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave; Hapat cilesore ose sasiore; Miratimi i nje Strategjie te re Kombetare per Parandalimin e Pastrimit te Parave dhe Kunder Financimit te Terrorizmit dhe Planit te saj te Veprimit 2024-2030. (Dhjetor 2024) | dokurnent), plani i veprimit duhet te jete 2025-2030. | | | Në këtë kontekst, edhe edhe plani i veprimit përfshin vitin 2024. |
| 5.4.2. Parandalimi efektiv i korrupsionit, zvogelimi i incidences se korrupsionit; Hapat cilesore ose sasiore; Kuadri ligjor per donacionet dhe sponsorizimet, si dhe per konfliktin e interesit dhe :financimin e partive politike, eshte ndryshuar ne perputhje me standardet evropiane dhe Komisioni Venecias (KV)/ GRECO dhe OSBE/ODHIR. (Qershor 2027) | Propozojme qe afati per hartimin e kuadrit ligjor per donacionet dhe sponsorizimet, te jete ne nje kohe me te afert, duke patur parasysh qe prej vitesh kjo eshte nje ceshtje e ngritur edhe nga Raporti i Bashkimit Evropian per Shqiperine. | Partners Albania | I papranuar | Në kuadër të linjëzimit të përgjithshëm të angazhimeve të AKR me dokumentat e tjerë strategjikë dhe politikë për integrimin evropian, edhe angazhimet e parashikuara për parandalimin efektiv dhe uljen e incidencës së korrupsionit janë harmonizuar me masat e parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM Nr. 736, datë 13.12.2023, në adresim të gjetjeve të Raportit të Shqyrtimit Analitik për Grupkapitujt “Themeloret”. Thënë kjo, afati për përshtatjen e kuadrit ligjor për donacionet dhe sponsorizimet me standardet evropiane dhe Rekomandimet e Komisionit të Venecias, GRECO-s [përfshirë Rekomandimin xiii), Raundi V i Vlerësimit të GRECO-s mbi dhurimet në Policinë e Shtetit – tashmë i adresuar në ligjin e ri Nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”] dhe OSCE/ODHIR është dakordësuar me Komisionin Evropian, siç parashikohet edhe në Udhërrëfyes. Afati në fjalë (qershor 2027) merr parasysh dhe inkorporon të gjitha fazat, nga identifikimi i nevojave për amendim deri te miratimi i tyre |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | në Kuvend, duke marrë në konsideratë kohën totale të nevojshme për të garantuar ndryshime ligjore të mirëmenduara, të konsultuara gjerësisht dhe të qendrueshme në kohë. |
| 5.5.2 Rritja e lirise se shprehjes, ne perputhje me standardet evropiane; Hapa cilesore dhe sasiore: Rritja e kapaciteteve te organeve te ligjzbatuese per te trajtuar rastet e dhunes, duke perfshire kufizimin e protestave, dhe ceshtje te tjera penale qe perfshijne gazetare , vecanerisht duke siguruar respektim te larte te te drejtave te njeriut ne trajtimin e incidenteve qe perfshijne gazetare , permes udhezimeve detyruese, mbledhjes se te dhenave dhe masave per ngritjen e kapaciteteve. (Qershor 2025) | Te shtohet " .... penale qe perfshijne gazetare dhe aktiviste te shoqërisë civile, vecanerisht duke siguruar respektim te larte te te drejtave te njeriut ne trajtimin e incidenteve qe perfshijne gazetare, dhe aktiviste te shoqerise civile ..... " | Partners Albania | I papranuar | Komenti i është përcjellë institucionit përgjegjës, për tu konsideruar në kuadër të zbatimit të masave AKR 2024-2027, si edhe politikave dhe programeve përkatëse. |
| 5.5.2 Rritja e lirise se shprehjes, ne perputhje me standardet evropiane; Hapa cilesore dhe sasiore: Miratimi i ndryshimeve te kuadrit ligjor per anti-SLAPP, ne perputhje me standardet e Keshillit te Europes/KV s dhe ne perputhje me acquis te BE-se dhe bazuar ne nje dialog te strukturuar dhe gjitheperfshires me | te shtohet " ... me aktoret e medias dhe organizatave te shoqerise civile." | Partners Albania | I pranuar | Komenti u pranua, duke u reflektuar plotësisht në draftin e Listës së Konsoliduar të Reformave (dhe në draftin narrativ). |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| aktoret e medias.<br>(Qershor 2027) | | | | |